REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**

**DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE, STREHIMIT, ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT**

**SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**

Adresa,*Rruga "Qafa e Gurit" VauDejës* nr. Tel:*Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vaudejes.gov.al*

Nr.6530 prot. Vau Dejës, më 08, 12, 2022

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Z. Mark Bisha**

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS**

**I nderuar zoti Kryetar!**

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin dhe relacionin, për:
"Për vazhdimësinë dhe vlerën e përfitimit të z. Dashamir Staf Kurtaj në Programin Social të Strehimit "Subvencionin e qirasë në tregun e lirë"

Me respekt!

**K R Y E T A R**
**MARK BABANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

**Konceptoi Specialist Strehimi: Anila Bashaj**
**Pranoi: P/Sektori Social: Çuka Babani**
**Miratoi: D/Drejtorie Devis Peci**

Datë: ____________

Nr. i faqeve A4 tëprojekt-vendimit: ____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: ____

Nr. i ifletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE, STREHIMIT, ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL
Adresa,*Rruga "Qafa e Gurit" VauDejës* nr. Tel:*Telefon/Faks 00355 2612 0006*, e-mail *e-mail: info@vaudejes.gov.al*

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 08 datë 09.12 2022

**"Për vazhdimësinë dhe vlerën e përfitimit të z. Dashamir Staf Kurtaj në Programin Social të Strehimit "Subvencionin e qirasë në tregun e lirë"**

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; nenit38 i Ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social"; VKM-së nr.384 prot, datë 12.06.2019"Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore";VKM-së nr.362 prot,datë 29.05.2019 "Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij"; Shkresës me nr.444/1 prot,datë 30.03.2021 nga Drejtoria e Statistikave Sociale, Tiranë mbi "Niveli e konsumit mesatar, të detajuar sipas madhësisë së familjes dhe për nivelin më të ulët territorial të disagrregimit, 2019 "; VKB-së nr.72,datë 23.12.2021 "Vendim pë miratimin e buxhetit te vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesem përfundimtarë 2022-2024,numrin e punonësve për Bashkine Vau Dejës"; VKB-së nr.84,datë 24.12.2020 "Mbi miratimin e Planit Social Vendor 2021-2023 në Bashkinë Vau Dejës"; VKB-së nr.48, datë 26.07.2021 "Për miratimin e Plani të Strehimit Social 2021-2026" në Bashkinë Vau Dejës; VKB-sënr.40, datë 28.06.2021 "Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit "Subvendion i qirasë , në tregun e lirë"; VKB Nr.16 me datë 28.03.2022 "Për ndyshimin e VKB Nr.42 datë 28.06.2021 "Për miratimin e ngritjes së Komisionit të strehimit " VKB-së nr.31, datë 26.05.2022 "Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit "Subvencionit të qirasë, në tregun e lirë" për vitin 2022; VKB-së nr. 25, datë 29.04.2022 "Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2022, për familjet qe perfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatese të banesave" të grupit të punës, i ngritur me Urdhër Nr. 526 datë 15.11.2022 "Për ngritjen e grupit të punës për

verifikime në terren”,; Proces-Verbalit përfundimatar i mbajtur nga **Komisioni i Strehimit me datën 09.12.2022**

“Për instrumentin financiar të subvencionit të qirasë, në tregun e lirë” i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës të :

**VENDOSI**

1. Miratimin e vzhdimësisë së përfitimit dhe vlerën e subvencionit të qirasë për z. Dashamir Staf Kurtaj në programin“Subvencion i qirasë në tregun e lirë”sipas tabelës dhe pjesës përbërëse të këtij vendimi.
2. Familja që ka përfituar subvencionin e qirasë mund të dalë nga kjo skemë pas një viti, nëse vërtetohet që ajo ka zgjidhur problemin e strehimit, ose nëse të ardhurat e familjes janë rritur mjaftueshëm për të përballuar pagesën e qirasë pa nevojën e bonusit, dhe skualifikohen sipas metodikës së përllogaritjes së qirasë, (VKB nr 40, datë 28.06.2021)
3. Familja që ka përfituar subvencionin e qirasë duhet të bëjne deklarimin pranë bashkisë ne rast se u ndryshojne kushtet e strehimit apo kushtet ekonomike. Familjet kane detyrim që brenda 10 ditëshit te para të muajit të gjashtë nga momenti i fillimit të subvencionit të qirasë, duhet të bëjnë përditesimin e informacionit rreth ndryshimeve të familjes për kushtet e strehimit ose kushtet ekonomike me dokumentat përkates, në të kundërt famija skualifikohet nga pagesa e subvencionit të qirasë,(VKB nr 40, datë 28.06.2021).
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet “Drejtoria e Mbrojtjes Sociale, Strehimit, Arsimit, Rinisë dhe Sportit”
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

**K R Y E T A R**
**MARK BABANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

**Konceptoi Specialist Strehimi: Anila Bashaj**
**Pranoi: P/Sektori Social: Çuka Babani**
**Miratoi: D/Drejtorie Devis Peci**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**
**DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE, STREHIMIT, ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT**
**SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**
Adresa,*Rruga "Qafa e Gurit" VauDejës* nr. Tel:*Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vaudejes.gov.al*

Nr._______ prot.

Vau Dejës, më 09. 12. 2022

**RELACION**

**"Për vazhdimësinë dhe vlerën e përfitimit të z. Dashamir Staf Kurtaj në Programin Social të Strehimit "Subvencionin e qirasë në tregun e lirë"**

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social", Bashkia Vau Dejës po zbaton disa nga programet e strehimit social, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

Subvencioni i qirasë si një instrument i programit të banesave sociale me qira, mbështet individë/familje që me të ardhura e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë. Subvencioni i qirasë realizohet nga bashkia kur nuk disponon banesa sociale me qira si dhe kur nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg.

Për këtë instrument në zbatim të programit të strehimit "Subvencion i qirasë, në tregun e lire"është ndjekur procedura për aplikime, sipasVKM-së nr.384 prot, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve dhe proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", të gjithë aplikuesit e kualifikuar në fazën e parë janë njoftuar për plotësimin e dokumentacionit në fazën e dytë, dhe janë mbështetur nga struktua përgjegjëse për strehim në Bashki.

Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB Nr.16 me datë 28.03.2022 "Për ndyshimin e VKB Nr.42 datë 28.06.2021 "Për miratimin e ngritjes së Komisionit të strehimit ", njoftuar me shkresë nr.4434 Prot datë 02.09.2022, realizoi mbledhjen në datën 09.12.2022 ku u bë shqyrtimi i dokumentacioneve të dosjes së z.Dashamir Staf Kurtaj, i cili ka përfituar në vitin 2021 nga ky program me VKB Nr. 66, datë 26.11.2021 "Vendim për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qerasë për aplikues në programin e "Subvencionit të qerasë në tregun e lirë".

Për llogaritjen e vlerës së subvencionit të qirasë Komisioni i Strehimit u bazua nëVKM-në nr.362 prot, datë 20.05.2019 "Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që

gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", dhe realizohet në varësi të të ardhurave të familjes sipas përcaktimeve ligjore dhe vlerës maksimale tëqirasë në treg të lirë të miratuar me VKB-nënr.41, datë 28.06.2021 "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave". Vlerat konkrete të subvencionit të qirasë për çdo përfitues përcaktohen sipas kontratave të qirasë të cilat nuk kalojnë vlerat e përcaktuara sipas Shtojcës "A" të VKM-së nr.362, datë 20.05.2019.

Vlera e subvencionit të qirasë është e pasqyruar në tabelën bashkëlidhur projekt vendimit nga ku është detajuar edhe efekti financiar që rrjedh për zbatimin e këtij programi që do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Vau Dejes.

Në këto kushte për realizimin e këtij programi të strehimit social duhet të miratohet në këshill bashkiak projekt vendimi i propozuar "Për vazhdimësinë dhe vlerën e përfitimit të z.Dashamir Staf Kurtaj në Programin Social të Strehimit "Subvencionin e qirasë në tregun e lirë"

**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!**

Konceptoi:
Anila Bashaj

**BASHKIA VAU DEJËS**
**Komisioni i Strehimit**

---

**Vau Dejës më 09.12.2022**

**Proces -Verbal përfundimtar**

**Instrumenti financiar "Subvencioni i qirasë, në tregun e lire"**

I mbajtur sot me datë 09.12.2022 ora 11:00, sipas shkreses nr.6863 prot, datë 06.12.2022 me lëndë "Për vazhdimësinë e përfitimit dhe shqyrtim të dokumentacionit të ripërditësuar dhe vlerës së përfitimit të z.Dashamir Staf Kurtaj në Programin Social të Strehimit "Subvencionin e qirasë në tregun e lirë" të strukturës përgjegjëse të strehimit në Bashki, në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; në ligjin nr.22/2018 "Për Strehimin Social"; VKM-në nr.384 prot, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"; VKM-së nr.362 prot, datë 29.05.2019 "Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij"; me VKB Nr.16 me datë 28.03.2022 "Për ndyshimin e VKB Nr.42 datë 28.06.2021 "Për miratimin e ngritjes së Komisionit të strehimit " VKB-së nr. 25, datë 29.04.2022 "Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2022, për familjet qe perfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatese të banesave" , bazuar i shpallur përfitues me VKB Nr. 66, datë 26.11.2021 "Vendim për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për aplikues në programin e "Subvencionit të qerasë në tregun e lirë" ku z. Dashamir Kurtaj ka dalë përfitues dhe sipas VKB Nr.40 datë 28.06.2021 mbi "Miratimin e proçedurave për zbatimin e programit social të strehimit "Subvencioni i Qirasë , në Tregun e Lirë " pika nr.3; u mblodh **Komisioni i Strehimit**.

**Antaret:**

- Ermira Mlloja- Kryetar
- Kristinë Shtatri- Zv/ Kryetar Jo-Present
- Renato Doda – Anëtar
- Gerralda Gogaj-Anëtar
- Edmond Gjecaj – Anëtar
- Atila Uligaj- Anëtar
- Kujtime Nurja-Anëtar

Komisioni i Strehimit mori në shqyrtim dosjen e z.Dashamir Staf Kurtaj, e vënë në dispozicion nga struktura përgjegjëse e strehimit në bashki dokumentacionin e plotë. Nga informacioni i dhënë nga specialisti i strukturës përgjegjëse.

Pas shqyrtimit për rregullsinë e kontratatës së qirasë si dhe dokumentacioneve të banorit, mbështetur në VKM-në nr.362 prot, datë 29.05.2019 "Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", Komisioni i Strehimit vendosi që :

1. Të miratojë vazhdimësinë e përfitimit si dhe vlerën e subvencionit të qirasë për familjen e z.Dashamir Kurtaj.

2.Familja që ka përfituar subvencionin e qirasë duhet të bëjne deklarimin pranë bashkisë ne rast se u ndryshojne kushtet e strehimit apo kushtet ekonomike. Familjet kane detyrim që brenda 10 ditëshit te para të muajit të gjashtë nga momenti i fillimit të subvencionit të qirasë, duhet të bëjnë përditesimin e informacionit rreth ndryshimeve të familjes për kushtet e strehimit ose kushtet ekonomike me dokumentat perkates, ne te kunder famija skualifikohet nga pagesa e subvencionit te qirase, (VKB nr 40, datë 28.06.2021).

**A-Familja përfituese:**

1. Dashamir Staf Kurtaj

**KOMISIONI I STREHIMIT**

1. **Ermira Mlloja- Kryetar**
2. **Kristinë Shtatri- Zv/ Kryetar** Jo - Prezent
3. **Renato Doda – Anëtar**
4. **Gerralda Gogaj-Anëtar**
5. **Edmond Gjecaj – Anëtar**
6. **Atila Uligaj- Anëtar**
7. **Kujtime Nurja-Anëtar**

Programi: Subvencioni i qirasë në tregun e lirë.

Vlera maksimale e subvencionit të qiras në tregun e lire, për familjet që përfitojn subvencionin e qiras në tregun e lirë , sipas strukturave përkatëse të banesave dhe të ardhurave të familjes

| Nr Rendor | Emër | Mbiemër | Kategoria sipas nenit 16, të ligjit nt.22/2018 | Përbërja Familjare | Struktura e Baneses | Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2022, për familjet qe perfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatese të banesave VKB nr. 25; datë 29.04.2022 | Qiraja reale | Të ardhurat Familjare mujore (neto) | Aftësia përballuese(%) | Qiraja e përballueshme | Subvencioni në muaj | Subvencioni ne muaj që mbulohet nga bashkia në Lek | Shuma që kërkohet nga buxheti i shtetit në Lek | Subvencioni në vit në Lek |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Dashamir | Kurtaj | Familje me të ardhura shumë të ulta sipas nenit 2, pika 45 e ligjit 22/2018 "Për Strehimin Social " | 5 | 2+1 | 15,500 | 10,440 | - | - | - | 10,440.0 | 10,440.0 | 0 | 125,280.0 |
| Totali/muaj | | | | | | | | | | | 10,440.0 | 10,440.0 | 0 | 125,280.0 |

Shënim ; Subvencioni i qirase fillon që në datën e nënshkrimit të kontratës , që në muajn tetor 2022- **deri në ndryshimin e kushteve social ekonomike të banorit** .

**KOMISIONI I STREHIMIT**

**1. Ermira Mlloja- Kryetar**

**2. Kristinë Shtatri- Zv/ Kryetar**

Jo - Present

**3. Renato Doda – Anëtar**

**4. Gerralda Gogaj-Anëtar**

**5. Edmond Gjecaj – Anëtar**

**6. Atila Uligaj- Anëtar**

**7. Kujtime Nurja-Anëtar**